



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Voltechz” të datës 31.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “155. Instalimi i elektrikës – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-23-5595-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Voltechz” të datës 31.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “155. Instalimi i elektrikës – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-23-5595-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Voltechz” (tutje “parashtruesi”) me datë 31.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “155. Instalimi i elektrikës – Ndërtimi i trafoblindës për kopshtin në Kolovicë” me nr. të prokurimit 616-23-5595-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Pas kërkeses për rishqyrtim AK pretendon se ne si OE nuk i kemi përmbushur kriteret e FTD ku është kerkuar një ingjiner i elektroenergjetikes me licens A dhe me ISO 5001 ku ne e kemi dorëzuar të gjitha kërkesat sipas AK por OE ankues pretendon se ing nuk di ti përdor pajisjet matese gje e cila nuk ka qene ne kriter për dosje tenderit mirpo kjo nuk qendron sepse një ing nuk mund të paiset me licens A dhe me ISO certifikat pa ditur gjerat elementare e cila është instrumenti mates, pra kjo nuk qendron as nga AK as nga OE ankues Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë".

Fillimisht duhet sqaruar që sipas letrës standarde mbi tenderuesin e eliminuar, arsyet për eliminimin e parashtruesit janë si në vijim:

#### ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- ☐ 1. Një (1) Inxhinier të certifikuar me licens A, për energji të jetë I certifikuar për përdorimin e pajisjeve matese

Dëshmia :

Të dorëzohet diploma e inxhinierit, ,licenca ,CV, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshjen mbi angazhimin e tij

- ☐ 2.Një (1)Inxhinieri I certifikuar me standardin ISO 50001;2015.

Dëshmia :

Kopja e diplomës Një (1)Inxhinieri I certifikuar me standardin ISO 50001;2015

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesën për inxhinier me licens A për energji i certifikuar për përdorimin e pajisjeve matese si dhe inxhinierin e certifikuar me ISO 50001:2015.

Në këtë mënyrë është gjetur se eliminimi ofertës së parashtruesit si të papërgjegjshëm nga komisioni vlerësues është i saktë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 08.09.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.